



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**DREJTORIA E SUBJEKTEVE ZGJEDHORE, MBIKËQYRJES, FINANCIMIT DHE**  
**MONITORIMIT**  
**SEKTORI I MBIKËQYRJES, FINANCIMIT DHE MONITORIMIT TË FUSHATËS**

Tiranë, më

Nr.

Prot.

**RELACION**  
**PROJEKTVENDIM**  
**PËR**  
**“MIRATIMIN E RAPORTIT MBI GJETJET NGA AUDITIMI I RAPORTEVE**  
**FINANCIARE TË PARTIVE POLITIKE PËR TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET**  
**PËR VITIN KALENDARIK 2022”**

Ky raport përmban gjetje nga auditimi që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) i ka bërë fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2022.

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Neni 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të ushtruar në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Neni 23, të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar, ka parashikuar afatet e dorëzimit të raporteve financiare vjetore, mënyrën e dorëzimit të raporteve, si dhe publikimin.

Neni 23/2, të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar, ka parashikuar caktimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjorë) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik.

Udhëzimi nr. 10, datë 21.4.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre dhe mënyrën e pagesës së audituesve”, përcakton mënyrën se si partitë politike duhet të raportojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në zbatim nenit 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 23, 23/2 dhe 23/4, pikat 1 e 2, “Për partitë politike”, të ndryshuar si dhe udhëzimit nr. 10, datë 21.4.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre dhe mënyrën e pagesës së audituesve”, është hartuar



projektvendimi “Për miratimin e raportit mbi gjetjet nga auditimi i raporteve financiare të partive politike për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin kalendarik 2022”.

## II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Brenda datës 31 mars të vitit pasardhës partitë politike kanë detyrimin të dorëzojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve raportin financiar vjetor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në fillim të vitit kalendarik i ka dërguar një shkresë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilën është kërkuar numri i partive politike të regjistruara në Gjykatë.

Në regjistrin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë janë të regjistruara 131 (njëqind e tridhjetë e një) parti politike.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve administroi 48 (dyzet e tetë) nga 131 (njëqind e tridhjetë e një) raporte financiare të dorëzuara nga partitë politike.

Pas dorëzimit të raporteve financiare nga partitë politike, KQZ caktoi ekspertët kontabël të licensuar (auditues ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2022 me Vendimin me Nr. 544, datë 22.5.2023, “Për përzgjedhjen e ekspertëve kontabël të licensuar (auditues ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2022”.

Ekspertët kontabël të licensuar (auditues ligjor) të përzgjedhur, referuar afateve të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2022, të përcaktuara në kontratën e lidhur me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, depozituan raportet e auditimit për 131 (njëqind e tridhjetë e një) parti politike.

Pas administrimit të raporteve të sipërcituara KQZ evidentoi mospërputhje në lidhje me ligjin për “Partitë Politike”, si dhe aktet nënligjore si më poshtë vijon:

- Mosdorëzimi i raporteve financiare vjetore nga 83 (tetëdhjetë e tre) parti politike;
- Moskryerjen e auditimit për 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) parti politike për shkak të adresave jo të sakta;
- Moskryerja e auditimit për 7 (shtatë) parti politike pasi nuk kanë bashkëpunuar me audituesit ligjorë;
- 4 (katër) parti politike janë shpallur në listën e subjekteve me statusin pasiv nga organet tatimore.

Ky projekt-vendimi është përcaktimi i masave administrative për partitë politike të cilat kanë shkelur rregullat dhe formatet e standardizuara të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për Partitë Politike” shqyrton dhe miraton projektvendimin “Për miratimin e raportit mbi gjetjet nga auditimi i raporteve financiare të partive politike për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin kalendarik 2022”.

**Jona JOSIFI** - Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit

**Majlinda CELMETA** - Drejtor i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

**Ylli MERKAJ** - Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
DREJTORIA E SUBJEKTEVE ZGJEDHORE, MBIKËQYRJES, FINANCIMIT DHE  
MONITORIMIT

RAPORT

MBI GJETJET NGA AUDITIMI I RAPORTEVE FINANCIARE TË PARTIVE  
POLITIKE PËR TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PËR VITIN KALENDARIK 2022

Përmbledhje

Në nenin 23 të Ligjit me Nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar, përcaktohet detyrimi i partive politike për të dorëzuar 1 (një) herë në vit në KQZ raportet financiare, të cilat duhet të mbajnë informacion të hollësishëm për:

- Burimet e financimit në bazë të formatit të standardizuar;
- Shpenzimet në bazë të formatit të standardizuar; dhe
- Subjektet e lidhura drejtpërdrejtë ose tërthorazi me partitë politike apo që kontrollohen prej tyre.

Neni 2, pika 1, i Udhëzimit me Nr. 10, datë 21.4.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre dhe mënyrën e pagesës së audituesve” përcakton dorëzimin e raporteve financiare nga partitë politike më 31 Mars të vitit pasardhës.

1. Dorëzimi i raporteve financiare vjetore të partive politike

Sipas të dhënave të Zyrës së Regjistrimit të Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, deri në datën 31 Dhjetor 2022, figurojnë të regjistruara 131 (njëqind e tridhjetë e një) parti politike. Në *Aneksin 1* bashkëlidhur këtij raporti gjendet lista e këtyre partive politike.

Nga këto, vetëm 48 parti dorëzuan në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve raportin financiar vjetor për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin kalendarik 2022 (këtej e tutje referuar si, RFV). Dorëzimi i RFV u bë brenda datës 31 Mars 2023, si afat i përcaktuar nga ligji.

Në vijim jepet lista e partive politike të cilat e dorëzuan RFV, brenda afatit:

- Partia Mendimi i Djathtë Liberal; “MDL”



2. Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë; “PAA”
3. Partia Aleanca Demokratike Shqiptare; “AD”
4. Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë; “ADK”
5. Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian; “A.M.I.E”
6. Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet; “ADS”
7. Partia Aleanca Popullore; “AP”
8. Partia Ardhmëria Shqiptare; “PASH”
9. Partia Balli Kombëtar; “PBK”
10. Partia Balli Kombëtar Demokrat; “PBKD”
11. Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar; “PBD”
12. Partia Bashkimi Liberal Demokrat; “BLD”
13. Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut; “PBDNJ”
14. Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar; “PBPPSH”
15. Partia Bindja Demokratike; “BD”
16. Partia Demokracia Sociale; “PDS”
17. Partia Demokrate për Integrim e Prosperitet; “P.D.I.P”
18. Partia Demokratike e Shqipërisë; “PD”
19. Partia Demokristiane e Shqipërisë; “PDK”
20. Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet; “PDIU”
21. Partia e Gjelbër; “P.GJ”
22. Partia e Lirisë; PL
23. Partia e Reformave Demokratike Shqiptare; “PRDSH”
24. Partia Emigracionit Shqiptar; “P.E.SH”
25. Partia Fryma e Re Demokratike; “FRD”
26. Partia Kombëtare Konservatore Albania; “PKKA”
27. Partia Komuniste e Shqipërisë; “PKSH”
28. Partia Konservatore; “KONS”
29. Partia Kristian Demokrate; “PKD”
30. Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim; “PLDN”
31. Partia Lëvizja e Legalitetit; “PLL”
32. Partia Lëvizja e Re; “LR”
33. Partia Lëvizja për Ndryshim; “LN”
34. Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar; “LZHK”
35. Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare; “PLPSH”
36. Partia Lista e Barabartë; “LIBRA”
37. Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen; “MEGA”
38. Partia Nisma Thurje; “NTH”
39. Partia Ora e Shqipërisë; “POSH”
40. Partia për Europianizim dhe Integrim e Shqipërisë; “PEISH”
41. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve Shqiptar; “PMDPSH”
42. Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë; “PPKDSH”
43. Partia Republikane Shqiptare; “PR”
44. Partia Shkodra 2015; “PSH2015”
45. Partia Socialdemokrate e Shqipërisë; “PSD”
46. Partia Socialiste e Moderuar; “PSM”

47. Partia Socialiste e Shqipërisë; “PS”

48. Partia Zgjidhja. “ZGJIDHJA”

## 2. Përzgjedhja e audituesve ligjorë

Me përfundimin e dorëzimit të këtyre raporteve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpalli njoftimin publik për rekrutimin e ekspertëve kontabël të licencuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2022. Pati 9 (nëntë) aplikime nga ekspertë kontabël të licencuar dhe pas verifikimit të dokumentacioneve të dorëzuar prej tyre, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve hodhi shortin për caktimin e partive politike për secilin prej auditues ligjorë të përzgjedhur. Me Vendimin me Nr. 544, datë 22.5.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përzgjedhjen e ekspertëve kontabël të licencuar (auditues ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2022”, u përzgjedhën ekspertët kontabël të licencuar (auditues ligjor), si dhe partitë politike që secili auditon, sipas *Aneksit 2* bashkëlidhur.

## 3. Auditimi për partitë politike të cilat dorëzuan raport financiar për vitin kalendarik 2022 dhe gjetjet përkatëse.

Audituesit ligjorë referuar afateve kontraktuale të lidhura me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, depozituan raportet dhe/ose informacionet për partitë politike të cilat kanë dorëzuar RFV, si më poshtë vijon:

1. Për Partinë “Mendimi i Djathtë Liberal” audituesi është shprehur se nuk ka mundur të kryejë auditimin për shkak të adresës së pasaktë të kësaj partie politike;
2. Për Partinë “Agrare Ambientaliste e Shqipërisë” audituesi ka kryer raportin e auditimit dhe e ka certifikuar;
3. Për Partinë “Aleanca Demokratike Shqiptare” audituesi është shprehur se nuk ka mundur të kryejë auditimin për shkak të adresës së pasaktë të kësaj partie politike;
4. Për Partinë “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë” audituesi nuk ka kryer auditimin pasi partia rezulton në listën e subjekteve me statusin pasiv;
5. Për Partinë “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian” audituesi është shprehur se nuk ka mundur të kryejë auditimin për shkak të adresës së pasaktë të kësaj partie politike ;
6. Për Partinë “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet” audituesja ka dërguar nëpërmjet postës njoftimin për fillimin e procedurave të auditimit. Letra e dërguar është marrë nga kryetari i partisë, z. Gaqo Apostoli. Pas këtij komunikimi nga ana e kryetarit nuk pati në vazhdim asnjë përgjigje për të kontaktuar në lidhje me fillimin e procedurave të auditimit;
7. Për Partinë “Aleanca Popullore” audituesi ka kryer raportin e auditimit dhe e ka certifikuar;
8. Për Partinë “Ardhmëria Shqiptare” audituesi nuk ka kryer auditimin pasi partia rezulton në listën e subjekteve me statusin pasiv;
9. Për Partinë “Balli Kombëtar” audituesi nuk ka kryer auditimin pasi partia rezulton në listën e subjekteve me statusin pasiv;

10. Për Partinë “Balli Kombëtar Demokrat” audituesi ka kontaktuar me kryetarin e partisë i cili i ka deklaruar se nuk kanë pasur asnjë të ardhur apo shpenzim si dhe nuk kanë përfituar fonde nga KQZ;
11. Për Partinë “Bashkimi Demokrat Shqiptar” audituesi ka kontaktuar me kryetarin e partisë i cili i ka deklaruar se nuk kanë pasur asnjë të ardhur apo shpenzim si dhe nuk kanë përfituar fonde nga KQZ;
12. Për Partinë “Bashkimi Liberal Demokrat” audituesi është shprehur se nuk ka mundur të kryejë auditimin për shkak të adresës së pasaktë të kësaj partie politike ;
13. Për Partinë “Bashkimi për të Drejtat e Njeriut” audituesja ka konstatuar se partia tek zëri i shpenzimeve “shërbime të tjera”, shumën në vlerën 836.422 lekë, që përfaqëson shpenzime për aktivitetin e partisë dhe shpenzime për karburantin nuk e kanë të shoqëruar me fatura të rregullta tatimore, por me kupona tatimor në të cilat nuk është i identifikuar blerësi;
14. Për Partinë “Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar” audituesi është shprehur se nuk ka mundur të kryejë auditimin për shkak të adresës së pasaktë të kësaj partie politike;
15. Për Partinë “Bindja Demokratike” audituesi ka komunikuar me financierin e partisë më shumë se një herë, por nuk i është dërguar asnjë informacion dhe si rrjedhojë nuk ka marrë asnjë të dhënë për këtë parti politike;
16. Për Partinë “Demokracia Sociale” audituesja ka konstatuar si më poshtë vijon:
  - Nuk janë deklaruar faturat e energjisë elektrike, ujësjellës, kanalizime e mirëmbajtje;
  - Nuk është deklaruar taksa e bashkisë për vitin 2021 dhe 2022, të cilat janë paguar në mars të vitit 2023 nga koordinatori i partisë;
  - Nuk është deklaruar asnjë staf i partisë në liste pagesë për të cilët kanë detyrimin ligjor të paguajnë sigurime shoqërore e shëndetësore dhe tatim mbi të ardhurat nga punësimi;
  - Nuk janë deklaruar mobilimi i zyrave të cilat janë të trashëguara nga periudhat e kaluara;
  - Partia ka refuzuar për pranimin dhe pagimin e faturës së shërbimit të auditimit.
17. Për Partinë “Demokrate për Integrim e Prosperitet” audituesi është shprehur se nuk ka mundur të kryejë auditimin për shkak të adresës së pasaktë të kësaj partie politike;
18. Për Partinë “Demokratike e Shqipërisë” audituesja ka konstatuar parregullsitë si më poshtë vijon:
  - Në shpenzimet e paraqitura si shpenzime për fushatën zgjedhore, ka një diferencë prej 2.215.662 lekë, të cilat nuk janë përfshirë në shpenzime fushate por janë paraqitur si shpenzime normale të partisë, ndërkohë që përshkrimi në faturë cilësohet si shpenzim për fushatën zgjedhore;
  - Në pasqyrat financiare partia nuk ka paraqitur të ardhura dhe shpenzime për degët e saj;
  - Nisur nga fakti se viti 2022 ka pasur zgjedhje të pjesshme, në pasqyrat financiare nuk janë paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet e kandidatëve.
19. Për Partinë “Demokristiane e Shqipërisë” audituesi ka kryer raportin e auditimit dhe e ka certifikuar;
20. Për Partinë “Drejtësi, Integrim dhe Unitet” audituesi ka kryer raportin e auditimit dhe e ka certifikuar;

21. Për Partinë e Gjelbër ” audituesi ka kryer raportin e auditimit dhe e ka certifikuar;
22. Për Partinë e Lirisë ” audituesi ka kryer raportin e auditimit dhe e ka certifikuar;
23. Për Partinë e Reformave Demokratike Shqiptare audituesi ka kontaktuar me kryetarin e partisë, i cili ka deklaruar se nuk kanë pasur asnjë të ardhur apo shpenzim si dhe nuk kanë përfituar fonde nga KQZ;
24. Për Partinë “Emigracionit Shqiptar” audituesi ka kontaktuar me kryetarin e partisë, i cili ka deklaruar se nuk kanë pasur asnjë të ardhur apo shpenzim si dhe nuk kanë përfituar fonde nga KQZ;
25. Për Partinë “Fryma e Re Demokratike” audituesi ka kryer raportin e auditimit dhe e ka certifikuar;
26. Për Partinë “ Kombëtare Konservatore Albania” audituesi është shprehur se nuk ka mundur të kryejë auditimin për shkak të adresës së pasaktë të kësaj partie politike;
27. Për Partinë “Komuniste e Shqipërisë” audituesja është shprehur se i është dërguar me postë rekomandë njoftimi për fillimin e procedurës së auditimit, zarfi me kërkesën është marrë në dorëzim në datë 13.10.2023, por asnjë përfaqësues i partisë nuk ka kontaktuar me audituesen;
28. Për Partinë “Konservatore” audituesi është shprehur se nuk ka mundur të kryejë auditimin për për shkak të adresës së pasaktë të kësaj partie politike;
29. Për Partinë “Kristian Demokratë” audituesi është shprehur se nuk ka mundur të kryejë auditimin për shkak të adresës së pasaktë të kësaj partie politike;
30. Për Partinë “Lëvizja Demokratike për Ndryshim” audituesja i ka dërguar njoftim zyrtar partisë nëpërmjet shërbimit postar për të filluar procedurat e auditimit. Njoftimi është marrë dhe firmosur, por nuk ka pasur asnjë njoftim nga ana e partisë qoftë telefonik apo zyrtar;
31. Për Partinë “Lëvizja e Legalitetit” audituesi ka kryer raportin e auditimit dhe e ka certifikuar;
32. Për Partinë “Lëvizja e Re” audituesi ka kryer raportin e auditimit dhe e ka certifikuar;
33. Për Partinë “Lëvizja për Ndryshim” audituesi nuk ka kryer auditimin pasi partia rezulton në listën e subjekteve me statusin pasiv;
34. Për Partinë “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” audituesi ka kryer raportin e auditimit dhe e ka certifikuar;
35. Për Partinë “Lëvizja Punëtore Shqiptare” audituesi nuk ka kryer auditimin pasi partia rezulton në listën e subjekteve me statusin pasiv;
36. Për Partinë “Lista e Barabartë” audituesi është shprehur se nuk ka mundur të kryejë auditimin për shkak të adresës së pasaktë të kësaj partie politike;
37. Për Partinë “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen” audituesi ka komunikuar dhe nuk i është dhënë informacion për detyrimet e pagave neto të palikuiduara që llogariten sipas raportimeve të listë pagesave të saj në organet fiskale si për vitin 2021 ashtu edhe për vitin 2022;
38. Për Partinë “Nisma Thurje” audituesi ka kryer raportin e auditimit dhe e ka certifikuar;
39. Për Partinë “Ora e Shqipërisë” audituesi ka kryer raportin e auditimit dhe e ka certifikuar;
40. Për Partinë “Për Europianizim dhe Integrim e Shqipërisë” audituesi është shprehur se nuk ka mundur të kryejë auditimin për shkak të adresës së pasaktë të kësaj partie politike;

41. Për Partinë “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve Shqiptarë” audituesi ka kontaktuar me kryetarin e partisë i cili ka deklaruar se nuk kanë pasur asnjë të ardhur apo shpenzim si dhe nuk kanë përfituar fonde nga KQZ;
42. Për Partinë “Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë” audituesi ka kontaktuar me kryetarin e partisë i cili ka deklaruar se nuk kanë pasur asnjë të ardhur apo shpenzim si dhe nuk kanë përfituar fonde nga KQZ;
43. Për Partinë “Republikane Shqiptare” audituesja ka konstatuar se partia shpenzimet për ambiente, transport/akomodim dhe financimin e degëve rajonale nuk e ka realizuar nëpërmjet llogarisë bankare, por nëpërmjet arkës;
44. Për Partinë “Shkodra 2015” audituesi është shprehur se nuk ka mundur të kryejë auditimin për shkak të adresës së pasaktë të kësaj partie politike;
45. Për Partinë “Socialdemokrate e Shqipërisë” audituesja ka konstatuar si më poshtë vijon:
- Paraqiten si shpenzime të periudhës vlerat e qirave të parapaguara për ambientet e selisë së partisë për 2 vitet e ardhshme në vlerën 9.611.473 leke, sipas kontratës noteriale të qirasë. Kjo vlerë duhej të ishte paraqitur si parapagim në pasqyrën e pozicionit financiar të saj te data 31.12.2022.
  - Likuidimet e pagave, të honorareve e ndihmave kryhen nëpërmjet arkës dhe jo nëpërmjet llogarive bankare.
  - Për honoraret e dhëna personave që nuk janë të regjistruar në listë pagesat e partisë nuk është llogaritur tatim në burim në masën 15% mbi vlerën e dhënë.
  - Partia nuk ka marrë certifikatën elektronike sipas kërkesave të ligjit nr. 87/2019, "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" dhe nenit 4, pika 2 të UMF nr. 16 datë 3.4.2020, i ndryshuar, si rrjedhojë nuk harton autofaturat tatimore elektronike për vlerat e qirave të paguara ndaj qiradhënësit për ambientet e selisë së saj sipas kërkesave të nenit 7, pika 3 të UMF nr. 16, datë 3.4.2020.
  - Blerjet e raportuara për vitin 2022 nuk mbështeten me fatura tatimore elektronike që duhet të lëshohen ndaj partisë me NIPT-in e saj.
46. Për Partinë Socialiste e Moderuar audituesi është shprehur se nuk ka mundur të kryejë auditimin për shkak të adresës së pasaktë të kësaj partie politike;
47. Për Partinë “Socialiste e Shqipërisë” audituesja ka konstatuar si më poshtë vijon:
- Partia nuk llogarit amortizim për ndërtesën që e ka me huapërdorje sipas vendimit nr. 196, datë 19.5.1992 të Këshillit të Ministrave. Vlera e ndërtesës me huapërdorje nuk është e rivlerësuar sipas kërkesave ligjore dhe paraqitet me vlerën e vitit 1993. Llogaritja e amortizimit bëhet sipas kërkesave të nenit 22, shkronja b të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar.
  - Partia nuk ka paraqitur të ndarë aktivitetin e saj vjetor të zakonshëm dhe aktivitetin për fushatën zgjedhore të datës 6.3.2022.
  - Pagesat e kryera për shpërblimin e fund vitit si dhe pagesat për punë shtesë nga disa punonjës të saj, nuk janë përfshirë në listë pagesat e raportuara në organet fiskale. Për të gjitha këto pagesa, është llogaritur dhe është raportuar gabim tatimi në burim me tarifë 15% kur duheshin raportuar si të ardhura personale duke llogaritur tatim mbi pagën për secilin punonjës.
  - Nuk janë kaluar nëpërmjet llogarive bankare pagesat ndaj disa punonjësve të jashtëm që kanë punuar për llogari të partisë, si dhe pagesat e shpërblimit të fund vitit.



48. Për Partinë “Zgjidhja” audituesi është shprehur se është dërguar njoftim nëpërmjet Whatsapp, në adresën e email-it, si edhe nëpërmjet postës. Njoftimi është marrë në dorëzim nga recepsioni, zj. Valbona Murizaj, në datë 9.11.2023 por nuk është kthyer asnjë përgjigje nga ana e partisë.

### 3. Auditimi për partitë politike të cilat nuk dorëzuan raport financiar për vitin kalendarik 2022 dhe gjetjet përkatëse.

Nga shqyrtimi i raporteve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve konstatoi se 83 (tetëdhjetë e tre) parti politike nuk e dorëzuan RFV për vitin kalendarik 2022. Lista e këtyre partive është si më poshtë vijon:

1. Partia Indipendenteve (Centriste) të Shqipërisë; “PICS”
2. Partia Përparimi Kombëtar i Shqipërisë; “PPKSh”
3. Partia e Blertë Shqiptare; “PBS”
4. Partia e Prosperitetit Demokratik të Shqipërisë; “PPDS”
5. Partia Nacional Demokrate Shqiptare; “PNDS”
6. Partia Universale Shqiptare; “PUSH”
7. Partia Unitetit Kombëtar; “PUK”
8. Partia Liberale Shqiptare; “PLS”
9. Partia Ekologjike; “PE”
10. Partia Lidhja Popullore Shqiptare; “PLPS”
11. Partia Socialpunëtore e Shqipërisë; “PSpS”
12. Partia Nacionaliste Shqiptare; “PNS”
13. Partia Socialreformiste e Shqipërisë; “PSS”
14. Partia Besëlidhja Kombëtare Demokratike Shqiptare; “PBKDS”
15. Lëvizja Demokratike për Vlëra Mirëqenie Progres; “LDVMP”
16. Partia Alternative Republikane; “PAR”
17. Partia e Djathtë Demokratike e Shqipërisë; “PDDS”
18. Partia Drejtësia Shoqërore; “PDS”
19. Partia Progresi Demokratik; “PPD”
20. Partia Mbrojtja e të Drejtave Kombëtare; “PMDK”
21. Partia Bashkimi Demokristian Shqiptar; “PBDS”
22. Partia Bashkësia Kombëtare Shqiptare; “PBKSh”
23. Partia e Re Socialiste e Shqipërisë; “PRSS”
24. Partia Triumfi i Legalitetit; “PTL”
25. Partia Ideali Demokratik Shqiptar; “PIDS”
26. Partia Rimëkëmbja Kombëtare; “PRK”
27. Partia Centriste Mirëqenies Popullore Shqiptare; “PCMPSh”
28. Partia Pajtimit Kombëtar; “PPK”
29. Partia Lëvizja për Demokraci; “PLD”
30. Partia Aleanca Demokracia e Re; “PADR”
31. Partia Lidhja Kombëtare Shqiptare; “PLKSh”
32. Partia Qytetare Shqiptare; “PQSh”

33. Partia Alternativa Liberale e Shqipërisë; “PALSh”
34. Partia Ideali Komunist; “PIK”
35. Partia Komuniste Shqiptare (e Rindërtuar); “PKShR”
36. Partia e Punës Shqipërisë; “PPSh”
37. Partia e të Majtës Demokratike Shqiptare; “PMDSH”
38. Partia Ambientaliste; “PA”
39. Partia Aleanca Nacionale Shqiptare; “PANSh”
40. Partia Lëvizja Monarkiste Demokrate Shqiptare; “PLMDSH”
41. Partia Rruga e Vërtetë Shqiptare; “PRrVSh”
42. Partia Demokrate e Re; “PDR”
43. Partia Demokracia Paqësore e Shqipërisë; “PDPSH”
44. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve; “PMDE”
45. Partia Aleanca Socialiste Shqiptare; “PASSh”
46. Partia Sigurisë Kombëtare Shqiptare; “PSKSh”
47. Partia Shpresa Demokrate; “PShD”
48. Partia e Biznesit Shqiptar; “PBSH”
49. Partia Komuniste e Shqipërisë 8 Nëntori; “PKSh8N”
50. Partia Demokratike Peza Gjirokastrë e Shqipërisë; “PDPGjSh”
51. Partia Integritit Social Kombëtar Shqiptar; “PISKSh”
52. Partia Lidhja e Blertë Shqiptare; “PLBSH”
53. Aleanca Popullore për Drejtësi; “APD”
54. Partia Lëvizja për të Drejtat e Njeriut; “PLDNj”
55. Partia Shqiptare Atdheu; “PShA”
56. Partia Demokracia e Re e Djathtë Shqiptare;
57. Partia e të Drejtave të Mohuara; “PDM”
58. Partia e Çështjeve Shqiptare; “PÇSh”
59. Partia Fronti i Majtë; “PFM”
60. Partia Shqipëria e Re; “PShR”
61. Partia Lëvizja Elitare Kombëtare; “PLEK”
62. Partia Shqiptare e Rindërtimit; “PShR”
63. Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare; “PLDSH”
64. Partia e të Drejtave të Mohuara - e Re; “PDMR”
65. Lista për Shqipëri Natyrore; “LShN”
66. Partia Aleanca Kombëtare; “PAK”
67. Partia Progresi Social Kombëtar; “PPSK”
68. Partia Aleanca për Europën; “PAE”
69. Partia Demokratike e Bashkimit Myslyman të Shqipërisë; “PDBMSH”
70. Partia "Ligj dhe Drejtësi"; “PLD”
71. Partia G99; “G99”
72. Partia Toleranca e Re e Shqipërisë; “PTRSh”
73. Partia Aleanca Europiane Ekologjike; “PAEE”
74. Partia Aleanca Arbnore Kombëtare; “PAAK”
75. Partia Lëvizja për Drejtësi e Shqiptarëve; “PLDSH”
76. Partia Personat me Aftësi të Kufizuar; “PPAK”
77. Partia Lëvizja Shqipëria e Re; “PLShR”

78. Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane; “PABDE”
79. Partia Lidhja për Drejtësi dhe Progres; “PLDP”
80. Partia Aleanca Kuq e Zi; “PAKZ”
81. Partia Forca Rinia; “PFR”
82. Partia Sfida për Shqipërinë; “PSSh”
83. Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare; “PLDSh”

Për 83 (tetëdhjetë e tre) partitë të cilat nuk dorëzuan RFV për vitin kalendarik 2022 audituesit ligjorë u shprehën se për 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) nuk kanë mundur të kryejnë auditimin për shkak se nuk kanë mundur t’i kontaktojnë për arsye të adresave të pasakta ndërsa me 7 (shtatë) parti politike nuk kanë pasur bashkëpunim. Këto gjetje janë si më poshtë vijon:

1. Partia e “Djathtë Demokratike e Shqipërisë”, është vënë në dijeni nëpërmjet postës dhe ka marrë zarfi e dërguar nga audituesja ligjore për fillimin e procedurave të auditimit, por nuk është mundur komunikimi i auditueses me këtë parti politike.
2. Partia “Aleanca Kombëtare”, është vënë në dijeni nëpërmjet postës dhe ka marrë zarfin e dërguar nga ana e auditueses për fillimin e procedurave të auditimit, por nuk i ka vënë në dispozicion asnjë dokument në lidhje me procesin e auditimit.
3. Partia “Ligj dhe Drejtësi”, është vënë në dijeni nëpërmjet postës dhe ka marrë zarfin e dërguar nga ana e auditueses për fillimin e procedurave të auditimit, por kjo mënyrë komunikimi rezultoi pa sukses, pasi letra është refuzuar të merret nga ana e partisë.
4. Partia “Komuniste Shqiptare (e Rindërtuar)”, është dërguar me postë rekomande njoftimi për fillimin e procedurës së auditimit, zarfi me kërkesën është marrë në dorëzim në datë 13.10.2023, por asnjë përfaqësues i partisë nuk ka kontaktuar me audituesen.
5. Partia “Përparimi Kombëtar i Shqipërisë”, audituesja i ka dërguar njoftim zyrtar partisë nëpërmjet shërbimit postar për të filluar procedurat e auditimit. Njoftimi është marrë dhe firmosur nga z. Myrto Xhaferri, por nuk ka pasur asnjë njoftim nga ana e partisë qoftë telefonik apo zyrtar.
6. Partia “Demokrate e Re”, audituesja i ka dërguar njoftim zyrtar partisë nëpërmjet shërbimit postar për të filluar procedurat e auditimit. Njoftimi është marrë dhe firmosur nga z. Pëllumb Matraku, por nuk ka pasur asnjë njoftim nga ana e partisë qoftë telefonik apo zyrtar.
7. Partia “Aleanca Arbnore Kombëtare”, audituesi ka komunikuar me financierin e partisë më shumë se një herë, por nuk i është dërguar asnjë informacion dhe si rrjedhojë nuk ka marrë asnjë të dhënë për këtë parti politike.

## 4. Konkluzione

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve konstaton paraprakisht se për deklarinimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të partive politike për vitin kalendarik 2022:

1. Ka ende një numër të konsiderueshëm partish politike të cilat për shkak të mos ushtrimit të aktivitetit politik, mungesës së njohurive për detyrimet ligjore sa i takon bërjes transparente të të hyrave dhe shpenzimeve, apo për arsye të tjera vijnë të mos dorëzojnë

raportet financiare vjetore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve sipas afateve ligjore dhe formateve të miratuara.

2. Për partitë politike të cilat kanë raportuar, ka ende pasaktësi në raportim, gabime apo mungesë bashkëpunimi me audituesit ligjorë që KQZ angazhon për këtë qëllim.

Në vijim të sa më sipër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të vijojë konsultimin publik të këtij raporti gjetjesh me: partitë politike, shoqërinë civile, median, partnerët ndërkombëtarë dhe qytetarët.

**Drejtör**

**Jona JOSIFI**



## Aneksi 1 - Lista e partive politike të regjistruara në regjistrin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

NR	Partia Politike	Shkronjat Nistore
1	Partia Demokristiane e Shqiperise	PDK
2	Partia Balli Kombëtar	PBK
3	Partia Socialiste e Shqipërisë	PS
4	Partia Demokratike e Shqipërisë	PD
5	Partia Indipendenteve (Centriste) të Shqipërisë	PI © SH
6	Partia Përparimi Kombëtar i Shqipërisë	PPKSH
7	Partia e Blertë Shqiptare	PBSH
8	Partia e Prosperitetit Demokratik të Shqipërisë	PPDSH
9	Partia Republikane Shqiptare	PR
10	Partia Nacional Demokrate Shqiptare	PNDSH
11	Partia Universale Shqiptare	PUSH
12	Partia Unitetit Kombëtar	PUK
13	Partia Socialdemokrate e Shqipërisë	PSD
14	Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë	PAA
15	Partia Liberale Shqiptare	PLSH
16	Partia Ekologjike	PE
17	Partia Lidhja Popullore Shqiptare	PLPSH
18	Partia Lëvizja e Legalitetit	PLL
19	Partia Socialpunëtore e Shqipërisë	PSP

20	Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	PBDNJ
21	Partia Nacionaliste Shqiptare	PNSH
22	Partia Aleanca Demokratike Shqiptare	AD
23	Partia Socialreformiste e Shqipërisë	PSRSH
24	Partia Beslidhja Kombëtare Demokratike Shqiptare	BDKSH
25	Lëvizja Demokratike për Vlera Mirëqënie Progres	LDVMP
26	Partia Alternative Republikane	PAR
27	Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar	BDSH
28	Partia e Djathtë Demokratike e Shqipërisë	PDDSH
29	Partia Drejtësia Shoqërore	PDSH
30	Bashkimi Liberal Shqiptar	BLD
31	Partia Progresi Demokratik	PPD
32	Partia Mbrojtja e të Drejtave Kombëtare	PMDK
33	Partia Konservatore	KONS
34	Partia Bashkimi Demokristian Shqiptar	PBDKSH
35	Partia Bashkësia Kombëtare Shqiptare	BKSH
36	Partia e Re Socialiste e Shqipërisë	PRSSH
37	Partia Triumfi I Legalitetit	PLT
38	Partia Ideali Demokratik Shqiptar	PIDSH
39	Partia Rimëkëmbja Kombëtare	PRK

40	Partia Centriste Mirëqënies Popullore Shqiptare	PCMPSH
41	Partia Pajtimit Kombëtare	PPK
42	Partia Lëvizja për Demokraci	LD
43	Partia Aleanca Demokracia e Re	ADR
44	Partia Lidhja Kombëtare Shqiptare	PLKSH
45	Partia Qytetare Shqiptare	PQSH
46	Partia Alternativa Liberale e Shqipërisë	PALSH
47	Partia Ideali Komunist	PIK
48	Partia Komuniste e Shqipërisë	PKSH
49	Balli Kombëtar Demokrat	PBDK
50	Partia Komuniste Shqiptare (e Rindërtuar)	PKSHR
51	Partia e Punës Shqipërisë	PPSH
52	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë	ADK
53	Partia Kombëtare Konservatore Albania	PKKA
54	Partia e të Majtës Demokratike Shqiptare	PMDSH
55	Partia Ambientaliste	PA
56	Partia Lëvizja Puntore Shqiptare	PLPSH
57	Partia Aleanca Nacionale Shqiptare	PAN
58	Partia Reformave Demokratike Shqiptare	PDRSH
59	Partia Lëvizja Monarkiste Demokrate Shqiptare	PLMDSH
60	Partia Rruga e Vertetë Shqiptare	PRVSH

61	Partia Kristian Demokrate	PKD
62	Partia Demokrate e Re	PDR
63	Partia Mendimi I Djathtë Liberal	MDL
64	Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	LZHK
65	Partia Demokracia Paqësore e Shqipërisë	PDPSH
66	Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve	PMDE
67	Partia Aleanca Socialiste Shqiptare	PASSH
68	Partia Sigurisë Kombëtare Shqiptare	PSKSH
69	Partia Shpresa Demokrate	SHD
70	Partia Aleanca Popullore	AP
71	Partia Ardhmëria Shqiptare	PASH
72	Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorve të Shqipërisë	PMDPSH
73	Partia e Gjelbër	PGJ
74	Partia e Biznesit Shqiptar	PB
75	Partia Emigracioni Shqiptar	PESH
76	Partia Komuniste e Shqipërisë 8 Nëntori	PKSH-8 Nëntori
77	Partia Demokracia Sociale	PDS
78	Partia Demokratike Peza Gjirokastrë e Shqipërisë	PDRGJSH
79	Partia Integritimit Social Kombëtar Shqiptar	PISKSH
80	Partia Lidhja e Blertë Shqiptare	LBSH



81	Aleanca Popullore për Drejtësi	APD
82	Partia Demokratike për Integrim e Prosperitet	PDIP
83	Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim European	AMIE
84	Partia Lëvizja për të Drejtat e Njeriut	LDLNJ
85	Partia Shqiptare Atdheu	PSHA
86	Partia Demokracia e Re e Djathtë Shqiptare	PDDRDSH
87	Partia e të Drejtave të Mohuara	PDM
88	Partia e Çështjeve Shqiptare	PÇSH
89	Partia e Lirisë	PL
90	Partia Ora e Shqipërisë	POSH
91	Partia Fronti i Majtë	PFM
92	Partia Shqipëria e Re	PSHRE
93	Partia Lëvizja Elitare Kombëtare	PLEK
